



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 2706 / prot.
4

Tiranë, më 26 .10 .2021

Lënda: Mbi fillimin e procesit zgjedhor për përzgjedhjen e anëtarëve në Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, në 3 (tri) njësitë kryesore të UMT-së

KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Këtu

Në vijim të mbledhjes së Senatit Akademik të UMT-së të zhvilluar më datë 13.10.2021, ku u diskutua mbi zhvillimin e procesit zgjedhor, me mbarimin e mandatit 2- vjeçar të anëtarëve të Komisioneve të Përhershme dhe kriteret që duhet të plotësojnë këta kandidatë për anëtarë në Komisionin për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në 3 (tri) njësitë kryesore të UMT-së, në vijim gjeni për zbatim bashkëlidhur Vendimin e Senatit Akademik të UMT-së nr. 78, datë 13 .10 .2021 “Për nisjen e procesit zgjedhor për Komisionet e Përhershme për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe miratimin e një ndër kriterëve që duhet të plotësojnë kandidatët që aplikojnë, për të qenë anëtarë në këto komisione”, Urdhrin e Rektorit nr. 119, datë 26 .10 .2021 “Për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë dhe dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët për anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” si dhe Urdhrin e Rektorit nr. 120, datë 26 .10 .2021 “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

REKTORI
ARBËN GJATA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2512 / Prot.
7

Tiranë, më 13 / 10 /2021

VENDIM
Nr. 78, datë 13.10.2021

**“PËR NISJEN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR KOMISIONET E PËRHERSHËME PËR
DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” NË NJËSITË KRYESORE TË
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË DHE MIRATIMIN E NJË NDËR
KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT QË APLIKOJNË, PËR TË
QENË ANËTARË NË KËTO KOMISIONE”**

Në bazë të neneve 3, 37, 38, 46 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 5, 25, 26, 32, 35 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në Vendimin e Senatit Akademik të UMT-së nr. 57, datë 27.09.2019 “Për nisjen e procedurave...” dhe sipas propozimit përkatës, Senati Akademik, pasi diskutoi mbi zhvillimin e procesit zgjedhor me mbarimin e mandatit 2-vjeçar të këtyre komisioneve të përhershme dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtarë në Komisionin e Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriterin si më poshtë:
 - Kandidatët për anëtarë në Komisionin e Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të mos jenë anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Ngarkohet Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) dhe njësitë kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të fillojnë procedurat përkatëse për zgjedhjen e anëtarëve të këtyre komisioneve sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe me daljen e urdhrave përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETARI
ARBEN GJATA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 2706 / prot
11

Tiranë, më 26 . 10 .2021

URDHËR
Nr. 120 , datë 26 . 10 .2021

PËR
“FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR DHE CAKTIMIN E DATËS SË ZHVILLIMIT
TE ZGJEDHJEVE PËR KOMISIONIN E PËRHERSHEM PËR DHËNIEN E GRADËS
SHKENCORE “DOKTOR” NË NIVEL NJËSIE KRYESORE, NË TË 3 (TRI) NJËSITË
NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në bazë të nenit 3, 39, 46 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 5, 28, 29, 32, 35 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, Vendimit të Senatit Akademik nr. 78, datë 13.10.2021 “Për nisjen e procesit zgjedhor për komisionet e përhershme për dhënie e gradës shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe miratimin e një ndër kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët që aplikojnë , për të qenë anëtarë në këto komisione” të UMT-së,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit zgjedhor për Komisionin e Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore, për të 3 (tri) njësitë në UMT, në datë 27.10.2021.
2. Votimi për Komisionin e Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në UMT, dhe për të 3 (tri) njësitë kryesore të UMT-të do të zhvillohen më 24.11.2021.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ), njësitë kryesore dhe Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

REKTORI
Prof. ARBEN GJATA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 2706 prot

Tiranë, më 26 .10 .2021

URDHËR

Nr. 119, datë 26 .10 .2021

PËR

**“PËRCAKTIMIN E KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË DHE
DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZONË KANDIDATËT PËR ANËTAR TË
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR” NË NIVEL NJËSIE KRYESORE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË”**

Në bazë të nenit 3, 39, 46 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 5, 28, 29, 32, 35 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, Vendimit të Senatit Akademik nr. 78, datë 13.10.2021 “Për nisjen e procesit zgjedhor për komisionet e përhershme për dhënie të gradës shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe miratimin e një ndër kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët që aplikojnë, për të qenë anëtarë në këto komisione” të UMT-së,

URDHËROJ:

1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për anëtar në Komisionin e Përhershëm për Dhënie të Gradës Shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në UMT, janë si më poshtë:
 - a) Të jetë personel akademik me kohë të plotë në njësinë kryesore përkatëse në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
 - b) Të mbajë titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.
 - c) Të mos jetë në ndjekje penale dhe ndaj tyre të mos jetë dhënë masë e sigurimit personal.
 - d) Të mos jetë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.
 - e) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
 - f) Të mos ketë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike” i ndryshuar dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
 - g) Të mos jenë anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

2. Dokumentacioni që duhet të dorëzojë për aplikim kandidati për anëtar në Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në UMT, është si më poshtë:
 - a) Kopje e dokumentit të Identifikimit ID/ Pasaportë.
 - b) Kopje të njësuar me origjinalin të diplomës/dëshmisë së titullit akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” ose vërtetim të lëshuar nga UMT-ja në mungesë të diplomës/dëshmisë.
 - c) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.
 - d) Vetëdeklarim që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
 - e) Vetëdeklarim se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit..” i ndryshuar, dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
 - f) Vetëdeklarim që nuk është anëtar i Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.
3. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në strukturat përkatëse zgjedhore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas vendimit të tyre.
4. Ngarkohet Komisioni Institucional Zgjedhor dhe njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij urdhri.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

REKTORI
Prof. ARBEN GJATA

